



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 10/2015

Prishtinë, më 3.3.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje anëtare.

Mungoi: Sasha Milosavljeviq, anëtar.

Pjesëmarrës të ftuar: Enver Halimi – ZRRE, Ramadan Sejdiu – MZHE, Blerim Sokoli – MTI, Artan Venhari – ZAP, Petrit Pepaj – KEDS.

Pjesëmarrës të tjerë: Gani Buçaj dhe Imer Fejzullahu – ZRRE, Agron Kamberi – KEDS, Dardan Abazi dhe Rinora Gojani – INDEP, Avni Bytyçi – GLPS, Floriana Shala – OSBE, Elton Bellopoja – NDI (praktikant), Besa Berisha – UNDP (praktikante).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 24.2.2015;
3. Zbatimi i Rekomandimeve të Kuvendit të datës 19.7.2013, lidhur me faturimin e shpenzimit të rrymës elektrike për muajin janar 2013, kohën e llogaritjes sipas tarifës së lirë, njehsorët dhe masat e ndërmarra në lidhje me këtë rast;
4. Te ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 24.2.2015;

Procesverbali i mbledhjes së datës 24.2.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Zbatimi i Rekomandimeve të Kuvendit të datës 19.7.2013, lidhur me faturimin e shpenzimit të rrymës elektrike për muajin janar 2013, kohën e llogaritjes sipas tarifës së lirë, njehsorët dhe masat e ndërmarra në lidhje me këtë rast;

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha se Komisioni hetimor parlamentar, në vitin 2013 ka bërë një raport lidhur me faturimin e shpenzimit të energjisë elektrike për muajin janar 2013, nga i cili Komisioni ka nxjerrë disa rekomandime në drejtim të Zyrës së Rregullatorit të energjisë, KEDS-it, Zyrës së Auditorit, Qeverisë dhe Kuvendit.

Qëllimi pse sot janë të ftuar përfaqësuesit e institucioneve që u adresohen Rekomandimet është që të vlerësohet se çka është ndërmarrë për zbatimin e atyre Rekomandimeve. Në vazhdim ai citoi rekomandimet si në vijim:

1. Rekomandohet që KEDS-i dhe ZRRE-ja, të marrin masat përkatëse për të përmirësuar komunikimin, kujdesin dhe transparencën ndaj konsumatorëve dhe aktorëve të interesuar lidhur me strukturën e tarifave dhe për t'iu siguruar atyre standardet e nevojshme në cilësi dhe sasi gjatë furnizimit me energji elektrike. Shërbimi dhe kujdesi ndaj konsumatorëve duhet të ngritet në një nivel shumë më të lartë. Rekomandohet që ZRRE-ja brenda gjashtë muajsh të informojë Kuvendin e Republikës së Kosovës, lidhur me masat e marruara nga ana e tij dhe KEDS/KKDFE, për të adresuar problemet e konstatuara me këtë Raport në këtë fushë.
2. ZRRE-ja duhet të bëjë një rishqyrtim të strukturës së tarifave dhe sidomos të blloqeve tarifore në dritën e zhvillimeve të reja në konsum dhe në vëllimin e strukturës së konsumit për të evituar rishpërndarjen e paarsyeshme të barrës dhe subvencionimin në dëm të konsumatorëve, që bëjnë pjesë kryesisht në bllokun tarifor III. ZRRE-ja duhet të ndërtojë-forcojë pavarësinë e vetë dhe nivelin e kompetencës profesionale në zbatimin kritereve për formimin e tarifave, duke evituar vendimet e diskutueshme sikurse është ky lidhur me zvogëlimin e kthimit në ekuitet. Duhet të evitohen situatat që krijojnë pasiguri dhe zvogëlojnë transparencën në formimin e tarifave.
3. Rekomandohet që ZRRE-ja të diskutojë-rishqyrtojë me KEDS/KKDFE, planin e investimeve, në mënyrë që investimet e zotuar nga Calik- LIMAK të bëhen me një dinamikë të përshpejtuar dhe me herët, në dobi të dyanshme për evitimin e humbjeve teknike e komerciale dhe ato të mbulohen e shlyhen në periudhën 15 vjeçare, sipas programit të investimeve për të siguruar stabilitet në tarifën e çmimit për konsumatorët.
4. Rekomandohet që të rishqyrtohet në mënyrë kritike nga ZRRE-ja dhe KEDS/ KKDFE i tërë projekti i furnizimit me orët elektronike nga aspekti i fizibilitetit të tyre teknologjik dhe ekonomiko-financiar dhe nevojës për zgjidhje që e lehtësojnë liberalizim dhe konkurrencën e tregut të furnizimit.
I rekomandohet Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, brenda këtij viti që të shqyrtojë performancën dhe procedurat e këtij projekti dhe për këtë ta informojë Kuvendin, përkatësisht Komisionet përkatëse.
5. I rekomandohet Kryeministrit të Republikës së Kosovës, që të ndërmarrë masat përkatëse sipas kompetencave të tij, për të siguruar zbatimin e plotë të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike dhe Ligjet e rregulloret përcjellëse për realizimin e pavarësisë së Bordeve të ndërmarrjeve publike si dhe rolit dhe përgjegjësisë së Rregullatorëve që i raportojnë Kuvendit. Me këto masa duhet të evitohen praktikatat që ministritë dhe ministrat të involvohen jashtë

autorizimeve në fushëveprimin e këtyre institucioneve dhe në mënyrën që dëmton forcimin e institucioneve të pavarura dhe sundimin e Ligjit.

6. Kuvendi i Republikës së Kosovës, duhet të insistojë në zbatimin me përpikëri të kornizës ligjore lidhur me rolin e Rregullatorëve, e cila siguron llogaridhënie dhe transparencë, si dhe vlerësim sistematik dhe të rregullt të performancës së Bordeve të Rregullatorëve; dhe
- 6.1. Qeveria e Republikës së Kosovës, duhet të insistojë në zbatimin me përpikëri të kornizës ligjore lidhur me kompetencat e rolin e Bordeve të ndërmarrjeve publike, e cila siguron llogaridhënie dhe transparencë, si dhe vlerësim sistematik dhe të rregullt të performancës së Bordeve të NP.

Pas leximit të rekomandimeve z.Mustafa, tha se ne kemi marrë raportet nga institucionet që iu adresohen Rekomandimet. Më tutje z.Mustafa elaboroi raportet në pika të shkurta. Lidhur me rekomandimin 1, ai tha se siç shihet në raport, ankesat e konsumatorëve janë zvogëluar nga viti 2012 deri në vitin 2014, por raporti nuk ka sqaruar se për çfarë lloji të ankesave bëhet fjalë, dhe do të duhej të sqarohej lloji i ankesave. Në vazhdim kryetari Mustafa, lidhur me raportet shtoi se të gjitha sikur janë për ruajtjen e gjendjes së njëjtë, ndërsa rekomandimet janë për ndryshimin e gjendjes. Shihet se ZRRE-ja ka bërë përpjekje, ka shqyrtuar strukturën tarifore, por edhe pas shqyrtimit struktura tarifore ka mbetë e njëjtë, tha Mustafa. Duke iu referuar raportit të ZRRE-së për zbatimin e Rekomandimeve, thuhet që nëse ndërrojnë tarifat rritet konsumi dhe ndikon negativisht në aspektin social, dhe lidhur me këtë pyeti se a ka hulumtime se struktura tarifore ekzistuese zvogëlon konsumin? Po ashtu, Mustafa pyeti se aspekti social i shqyrtimit të tarifave, a është çështje e Rregullatorit apo e Qeverisë dhe sa është e drejtë kjo? Nga kjo perspektivë i bie që ai i cili shpenzon më shumë, paguan për atë që shpenzon më pak theksoi z.Mustafa. Lidhur me tarifat e energjisë për bizneset, ai tha se janë të larta dhe pyeti se sa ndikojnë në konkurrencën e bizneseve vendore me ato të rajonit. Një konstatim tjetër që shihet në raportin e ZRRE-së, z.Mustafa tha, se është që në qoftë se konsumojmë më shumë rritet importi, derisa çmimet e importit janë më të larta, dhe rrjedhimisht reflekton në tarifat e energjisë, kurse për investimet theksoi se natyrisht se investimet varen sipas kontratës së privatizimit, por të gjendet një model që i përshpejton investimet, dhe ky është një sugjerim i Komisionit, pra investimet nuk duhet të varen prej të hyrave nga tarifat. Sa i përket orëve matëse, ai tha se për këtë çështje nuk do të diskutohet sot, meqenëse rasti është duke u hetuar nga Prokuroria. Kryetari tha se kam pranuar një draft raport nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm – ZAP, por ai ende nuk është final dhe nuk është për publikun, theksoi Mustafa.

Enver Halimi – ZRRE, falënderoi kryetarin për ftesën dhe u fokusua në elaborimin e bazës ligjore të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Ai shprehu shqetësimin e tij lidhur me pavarësinë vendimmarrëse dhe pavarësinë financiare të ZRRE-së, e cila siç tha ky, nuk është në nivelin e duhur. Më tutje ai shtoi se ZRRE-ja është në mes të dy palëve: konsumatorit dhe të licencuarve dhe gjatë shqyrtimit të tarifave duhet të kenë në konsideratë të dyja palët. Duke iu referuar takimit të sotëm z.Halimi tha se ZRRE-ja ka pranuar një kërkesë nga Komisioni më 10 shkurt 2015, për me raportuar lidhur me masat e ndërmarra si rezultat i Rekomandimeve të Komisionit hetimor. Ai tha se kemi bërë analiza, konsulta publike lidhur me strukturën tarifore dhe pas shqyrtimit të gjithanshëm, përsëri ka rezultuar që të mbetet edhe më tutje struktura e njëjtë tarifore. Ai shtoi se ZRRE-ja ka disa vërejtje lidhur me raportin e Komisionit hetimor, por theksoi se nuk dëshiron që të kthehet në diskutimin e tyre, dhe theksoi se ato vërejtje lidhen me krahasimin e tarifave me vendet e rajonit.

Petrit Pepaj – KEDS, tha se në qershor të vitit 2014, e kemi dërguar planin e investimeve në ZRRE dhe është miratuar nga ZRRE-ja, dhe shtoi se kah fundi i vitit 2014 kemi kontraktuar një kompani që të hartojë planin e detajuar të investimeve. Në vazhdim Pepaj tha se vitin që shkoi, është kërkuar të ndryshohet struktura tarifore për arsye se konsumatorët po kanë vështirësi të kuptojnë strukturën tarifore ekzistuese. Gjatë shqyrtimit të tarifave ZRRE-ja ka mbajtur konsultime

me ekspertë, dhe me aktorë të tjerë relevantë dhe ka bërë analiza të strukturës tarifore dhe pas të gjitha këtyre veprimeve ka arritur të konkludimi se struktura tarifore ekzistuese edhe më tutje të mbetet e njëjtë. Lidhur me shërbimet ndaj konsumatorëve Pepaj, tha se KEDS-i në 35 qendra mund të bëhen ankesa nga konsumatorët. Ai shtoi se shërbimi ndaj konsumatorit është përmirësuar, numri i ankesave ka shënuar rënie, gabimet në lexim të njehsorëve janë minimale. Në fund z.Pepaj tha se ne si investitorë privat jemi të përkushtuar për kujdesin ndaj konsumatorëve.

Artan Venhari – ZAP, tha se bazuar në rekomandimet, ne shohim dy çështje procedurat dhe performancën dhe shtoi se sa i përket aspektit të furnizimit me orët elektronike, procedurat e ndjekura janë në rregull ndërsa performanca ka probleme por që pritet të sqarohen. Ai sqaroi se ZAP-i nuk ka kompetencë të ndërhyjë në ndërmarrjet private.

Kryetari Mustafa, shtoi se KEDS-i është ndërmarrje private por kryen shërbim publik për qytetarët, andaj duhet të kontrollohet për vitin 2013-2014.

Ramadan Sejdiu – MZHE, tha se rekomandimi 6, i adresohet Qeverisë dhe shtoi se ky rekomandim është i zbatuar me legjislacionin ekzistues, ai i cili është. Njësia për monitorim të ndërmarrjeve publike – NJMNP, ka bërë vlerësimin e performancës së tyre dhe ato vlerësime janë të paraqitura në raportet e performancës, sqaroi Sejdiu. Më tutje ai theksoi se me këtë nivel të legjislacionit dhe të bordeve aktuale, nuk mund të presim një qeverisje më të mirë korporative të ndërmarrjeve publike dhe shpresojmë që bordet e reja të jenë më kualitative.

Besim Beqaj tha se ne sot jemi duke diskutuar për një dokument të veçantë lidhur me tarifat e energjisë elektrike për një kohë të caktuar dhe shtoi se jemi duke folur për një sektor të rregulluar. Në vazhdim z.Beqaj theksoi se Raporti i Komisionit hetimor mund të ketë gabime teknike, por nuk paraqet ndonjë problem. Më tutje ai tha se një Rekomandim i Kuvendit nuk është e domosdoshme të pranohet ashtu si është. Ai iu referua Rekomandimit për shqyrtimin e strukturës tarifore, duke thënë se shqyrtimi i strukturës tarifore përfshin në vete shumë elemente që duhet të merren parasysh në shqyrtimin e strukturës tarifore. Lidhur me investimet, Beqaj tha se investitori ka kërkuar të rrisë investimet në tri vitet e para por ZRRE-ja nuk ka pranuar sepse rrit çmimin e energjisë, dhe shtoi se nëse flasim për dinamikë të investimeve ka efekt të drejtpërdrejt në çmime. Beqaj theksoi se duhet të kërkojmë reduktimin e humbjeve teknike dhe komerciale. Ne sot, tha ai, duke iu drejtuar përfaqësuesit të ZRRE-së, do t'ju japim një sugjerim që ta rishqyrtoni, pse jo, përsëri strukturën tarifore duke respektuar Rekomandimet. Qytetarët nuk po e kuptojnë strukturën tarifore dhe duhet t'ia shpjegoni qytetarëve mënyrën e faturimit dhe po ashtu t'ia shpjegoni atyre edhe mundësitë për kursim të energjisë, tha në fund Beqaj.

Kryetari Muhamet Mustafa, sqaroi se në raport të Komisionit hetimor sqarohet se për rajon është marrë mesatarja e tarifave, ndërsa në Kosovë është marrë tarifa e bllokut të tretë, dhe shtoi se për caktimin e tarifave merren parasysh shumë elemente. Kryetari kërkoi nga ZRRE-ja të sqarojë se pse KEK-u ia shet energjinë elektrike për rreth 27 euro KEDS-it ndërsa KEDS-i konsumatorit ia faturon rreth 56 euro. Po ashtu tha se në përcaktimin e tarifave për bizneset duhet të shohim se sa jemi konkurrent me bizneset e rajonit. ZRRE-ja duhet të angazhohet më shumë në dy çështje të rëndësishme në tarifat dhe cilësinë e investimeve.

Visar Ymeri tha se kostoja të cilën e faturojnë nga gjenerimi dhe kostoja të konsumatori është si rrjedhojë e keqkuptimit të energjisë, duke shtuar se energjia është mall për shitje apo infrastrukturë e nevojshme për qytetarë, dhe theksoi se energjia elektrike duhet të konsiderohet si infrastrukturë e nevojshme për qytetarë, e jo si mall për shitje. Ai tha se qëllimi është të furnizohet konsumatori i fundit me koston gjenerale. Po ashtu tha se si vend kemi energji apo rezervat energjetike me të cilat krahasohemi me vendet tjera. Ai shtoi se në momentin që po hyn

privatizimi mandej energjia po trajtohet si mall e jo si infrastrukturë. Lidhur me shqyrtimin e strukturës tarifore dhe çmimit të tarifave, Ymeri tha se prej vitit 2012, tri herë ka pasur rritje të tarifave, madje vetëm në vitin 2014 ka pasur dy herë rritje të çmimit të tarifave, dhe shtoi se prej Raportit hetimor deri sot nuk kemi marrë asgjë nga asnjë institucion, lidhur me masat e ndërmarra bazuar në rekomandimet e Komisionit hetimor. Dokumentet që merren parasysh për përcaktimin e çmimeve duhet të jenë publike tha Ymeri, dhe shtoi se kemi kërkuar nga ZRRE-ja informatë lidhur me përcaktimin e çmimeve të tarifave, por nuk na është dhënë informata që e kemi kërkuar. Lidhur me investimet, tha se thuhet se janë investuar 18 milionë euro, por nuk dihet çfarë investime janë bërë, nuk dihet a po reduktohen humbjet, a po reduktohen humbjet komerciale apo humbjet teknike. Më tutje Ymeri tha se me privatizim duhet që të vijë edhe një kapital i freskët në Kosovë, me të njëjtën strukturë të çmimeve, e jo investimet të bazohen vetëm në fatura. Lidhur me rekomandimin 6, ai tha se nuk kemi një përgjigje të qartë dhe kërkoi nga Ministria të bëjë një raport më të detajuar e jo dy faqe siç i ka sjellë tani.

Blerim Grainca tha se është bërë një lloj sëmundje raportimi me vonesë. Duke iu referuar komentit të përfaqësuesit të ZRRE-së, se ZRRE-ja është në mes të konsumatorit dhe të licencuarve, ai tha se është qytetari ai i cili po gjendet në këtë “sendiç” të kësaj problematike. Numri i ankesave mbetet shqetësues, pasi që ka shumë qytetarë të tjerë që nuk kanë bërë ankesa u shpreh Grainca. Sa i përket çmimit 27 euro nga KEK-u ndërsa 56 nga KEDS-i Grainca kërkoi që të rishqyrtohen këto çmime. Lidhur me investimet ai tha se ato duhet të rriten.

Pal Lekaj tha se nga Raporti i Komisionit hetimor kanë dalë 6 Rekomandime, por nuk është dhënë informatë nga institucionet që i adresohen se çka është ndërmarrë. Për transparencë flitet mjaft por nuk ndodh në realitet shtoi Lekaj. Sa i përket dinamikës së investimeve, ai tha se u përmend shifra prej 18 milionë, por nëse dalim në terren nuk shihen ato investime dhe pyeti se ku janë ato investime? Ai e paraqiti si shqetësuese stërshtjen e energjisë elektrike 27 euro KEK-u, 56 dhe 82 euro nga KEDS-i. Gjithashtu ai shprehu shqetësimin lidhur me dëmet që po i bëhen konsumatorëve nga energjia elektrike.

Raif Qela tha se me njehsorët e vjetër ka pasur edhe shumë ankesa, dhe pyeti se sa orë matëse janë ndërruar me të reja? Ai tha se ende shumica e njehsorëve janë të vjetër. Duke folur për ankesat, ai tha se një pjesë e madhe e ankesave janë për lexim të njehsorëve dhe kërkoi kontroll më të madh ndaj lexuesve të njehsorëve. Në vazhdim Qela pyeti se sa njehsorë kanë mbetur të vjetër dhe sa është zvogëluar numri i konsumatorëve?

Enver Hoti duke iu referuar komenteve të përfaqësuesit të MZHE-së se legjislacioni dhe bordet duhet të jenë më kualitative, pyeti se cili do të jetë angazhimi i Ministrisë për ndryshim pozitiv në drejtim të legjislacionit dhe bordeve? Lidhur me kujdesin ndaj konsumatorëve Hoti tha se 35 qendra janë të pamjaftueshme për numrin e madh të konsumatorëve dhe shtoi se këto qendra nuk janë në nivelin e duhur të komunikimit, dhe bazuar në kthimin e përgjigjeve ndaj ankesave të konsumatorëve më tepër e dekurajojnë konsumatorin.

Fatmir Rexhepi kërkoi që ZRRE-ja duhet ti bënë krahasimet e çmimeve për amvisëri dhe për industri edhe me vendet tjera. Të shohim modelin e faturimit, të shohim se çka mund të bëjmë për tarifën në industri, dhe të shohim se ku jemi në raport me vendet tjera dhe kërkoi të ketë një raport për këtë çështje.

Petrit Pepaj – KEDS tha se pas rekomandimeve të Komisionit hetimor kemi ndërmarrë veprime për komunikim me të madh me konsumatorët dhe kemi përgatitur një fletushkë ku shpjegohet struktura tarifore dhe pranoi se struktura tarifore megjithatë nuk është aq e lehtë për t'u kuptuar nga konsumatorët. Ai tha se KEDS-i është nën monitorim të përditshëm nga ZRRE-ja.

Imer Fejzullahu – ZRRE, tha se në përcaktimin e tarifave, aspekti social është edhe obligim ligjor ku kërkohet që tarifat të jenë në përputhje me kohezionin social. Sa i përket liberalizimit të tregut, ai tha se njehsorët nuk ndikojnë në liberalizim të tregut. Lidhur me investimet kapitale Fejzullahu tha se rreth 80% e investimeve janë bërë në rrjet. Ai shtoi se të gjitha raportet janë të publikuara, ndërsa për ankesa, tha se në rreth 5 milion fatura janë bërë rreth 17 mijë ankesa.

Pas debatit Komisioni, njëzëri, nxori këto

Konkluzione

1. *ZRRE dhe KEDS të vazhdojnë rishqyrtimin e dinamikës së investimeve për zvogëlimin më të shpejtë të humbjeve teknike dhe komerciale me një përkujdesje për nivelin e tarifave.*
2. *ZRRE të përgatisë një analizë krahasuese gjithëpërfshirëse lidhur me tarifat e energjisë me vendet e rajonit sidomos lidhur me tarifat për biznese dhe efektet e këtyre tarifave në aftësinë konkurruese.*

5. Të ndryshme.

a) Besim Beqaj në cilësinë e udhëheqësit të Grupit të Punës për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit për investimet e huaja, njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me procesin e mbikëqyrjes, duke thënë se deri më tani kemi hartuar dhe miratuar një plan veprimi dhe kemi mbajtur dy mbledhje. Sot i kemi takuar përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë nga Agjencia për Investime dhe përkrahjen e ndërmarrjeve dhe nga Departamenti Ligjor, dhe i kemi kërkuar përgjigje me shkrim në pyetjet e ngritura lidhur me zbatimin e ligjit. Në vazhdim z.Beqaj i njoftoi anëtarët e Komisionit me agjendën e grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për investimet e huaja.

b) Kryetari i Komisionit Muhamet Mustafa, tha se tash jemi në një fazë kur do ta shqyrtojmë dhe amendamentojmë projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për ndërmarrjet publike. Deri me tani Projektligji ka kaluar leximin e parë, gjithashtu edhe kemi organizuar dëgjim publik me palët e interesuara. Koha për propozim të amendamenteve ka kaluar, po ashtu tha se kemi pas takim konsultativ edhe me ekspertë dhe tani duhet të vazhdojmë me amendamentim. Kryetari Mustafa tha se grupi i punës do të takohet këtë javë, ndërsa mbledhja e Komisionit do të mbahet të martën, më 10 mars 2015, ku do të shqyrtohen amendamentet e grupit të punës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa